



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.340/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkritazi me ankesën e organizatës Rjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prizren, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e organizatës Rjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prizren, dega në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 200 (*dyqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, me datën 22.10.2017, ka pranuar një ankesë nga organizata Rjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se kandidatja Tringa Morina nga radhët e subjektit politik AAK në Prizren, përmes faqes së rrjetit social Facebook, pra nga profili i saj ka shpërndarë përmbajtje, që bënë thirrje të votohet subjekti i saj politik.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është thyer heshtja zgjedhore, dhe nga ky veprim është bërë shkelje e dispozitës së nenit 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në Përgjigje në ankesë të datës 23.10.2017 nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës theksohet se, ankesa e bërë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA është keqpërdorim i ankesës, ku vërehet qartë se postimi që na është dërguar nuk ka datë që e konfirmon se ka ndodhur heshtja zgjedhore në ditën e zgjedhjeve. PZAP-it i ka kërkuar që të marrë parash veprimet e subjektit politik AAK-së, duke njoftuar strukturat e saj partiake që ta respektojnë ligjin dhe rregullat ligjore të KQZ-së. Përgjigjes në ankesë I ka bashkangjitur 5 fotografi si dëshmi në cilësi të proves.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoj shkresat e lëndës, në kuptim të dispozitës së nenit 117 paragrafi 2 të LZP-së, konstatoj se:

Ankesa është e bazuar

Paneli pas shqyrtimit të proves, fotografisë së bashkangjitur në ankesë ka vlerësuar në mënyrë të qartë dhe bindëse se kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik, Aleanca Kosova e Re (AKR), Tringa Morina, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e saj social Facebook nga përmbajtja e sms të saj rezulton se e njëjta ka bërë fushatë zgjedhore në ditën e votimit, duke shpërndarë fotografimin e saj me të cilin veprim ka bërë thirrje për ta votuar .

Andaj Paneli duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK), është përgjegjëse për veprimet e saja, pasi që këto veprime paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike dhe kandidatët, të përcaktuara me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton se: “24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre”.

Paneli në kuptim të nenit 118 pika dhe nenit 120. të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr. 340/2017 më datën 24.10.2017



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.